



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 9.9.2019

Lënda: Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, datë 9.9.2019, për çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, magjistrat/gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën gjyqësore publike të datës 26.7.2019, për çështjen (JR) nr. 29/2018, datë 5.11.2018, që i përket ankimit të paraqitur nga Komisioneri Publik kundër vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit z. Gentian Medja, trupi gjykues vendosi mbylljen e shqyrtimit gjyqësor dhe ftoi palët të paraqesin konkluzionet përfundimtare në seancën e datës 9.9.2019.

Në vijim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes në fjalë, pasi u administruan, shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor shkaqet e ankimit, prapësimet dhe provat e paraqitura, Komisioneri Publik parashtron pretendimet e tij përfundimtare në këtë gjykim.

Në vlerësim të Komisionerit Publik, shqyrtimi gjyqësor nga ana e Kolegjit i ankimit, në referencë të nenit 179/b, pika 5, i Kushtetutës, nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 dhe 3 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, nisur nga fakti se objekti i këtij ankimi ishte në funksion të miratimit dhe të përdorimit të një metodologjie vlerësimi më efektive, lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, propozuar dhe në përmbajtjen e rekomandimit të një komisioni prej tre vëzhguesish ndërkombëtarë, evidentoi jo vetëm kompleksitetin e çështjes, por dhe disa mangësi procedurale dhe materiale në drejtim të plotësimit të indikatorëve dhe nënindikatorëve, referuar burimeve të vlerësimit profesional të magjistratëve të parashikuar nga ligji nr. 96/2016.

Këto mangësi u vërejtën në disa burime të kontrollit të kriterit të aftësisë profesionale, si: (i) mungesa e dosjes personale të magjistratit, parashikuar nga neni 77, germa “a”, e ligjit nr. 96/2016; (ii) mungesa e mendimit të Kryetarit të Gjykatës, parashikuar nga neni 77, germa “d”, e ligjit nr. 96/2016; (iii) mungesa e informacionit me shkrim, që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, parashikuar nga neni 77, germa “e”, e ligjit nr. 96/2016.

Ky konstatim në rastin konkret ishte i domosdoshëm, si për sa i takon vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ashtu dhe në funksion të hartimit dhe miratimit të një

metodologjie më specifike dhe të detajuar të vlerësimit të këtij kriteri, në të cilën të pasqyrohen në mënyrë të detajuar indikatorët e vlerësimit të aftësive profesionale sipas ligjit nr. 96/2016, si dhe orientimit të organeve të rivlerësimit mbi disa udhëzime të përgjithshme, mbi qasjen dhe metodologjinë e aplikueshme mbi vlerësimin e tyre.

Komisioneri Publik, në vlerësim të sa u administrua dhe u trajtua gjatë shqyrtimit gjyqësor, në raport me shkaqet e ankimit, si dhe për sa u vendos nga trupi gjykues në seancat e zhvilluara, parashtron si vijon:

I. Lidhur me *nevojën për miratimin e një metodologjie më specifike dhe të detajuar të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, në të cilën pasqyrohen në mënyrë të detajuar burimet e vlerësimit të aftësive profesionale sipas ligjit nr. 96/2016*

Për këtë shkak ankimi, Komisioneri Publik ka vlerësuar se hetimi administrativ, analizimi i gjetjeve të rezultateve të hetimit administrativ për kriterin e aftësive profesionale në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Medja, nuk ishte konkret dhe i detajuar, dhe bazohej në një vlerësim jo të plotë të burimeve të vlerësimit të aftësive profesionale sipas ligjit nr. 96/2016.

Komisioneri Publik vlerëson se, nëse gjetjet, *ku në rastin konkret nga shqyrtimi i 13 çështjeve të vlerësuara për subjektin e rivlerësimit, z. Gentian Medja, janë konstatuar të njëjtat problematika*, do të analizoheshin për çdo burim vlerësimi të parashikuar nga ligji nr. 96/2016, duke i dhënë një vlerë të matshme konkrete, pozitive apo negative (+/-), do të qartësonin nëse kemi të bëjmë më një “*model të metash*”, që të çojnë në një përfundim të ndryshëm në lidhje me nivelin e vlerësimit të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, apo për vlerësimin e tij do të ishte i nevojshëm kërkimi ose jo i burimeve shtesë të vlerësimit.

Kësaj kërkesë procedurale, në konsideratë të ankimit dhe të parashtrimeve të Komisionerit Publik, Kolegji iu përgjigj duke propozuar ai vetë, nëpërmjet këtij trupi gjykues, një draftmetodologji, për të cilën Komisioneri Publik mbajti qëndrim në seancën e datës 17.7.2019, duke vlerësuar se është e plotë nga pikëpamja strukturore, por që të konsiderohet e zbatueshme në funksion të hetimit të duhur të çështjes, nevojitet edhe administrimi në cilësinë e provës i tri burimeve shtesë të vlerësimit, në përputhje me burimet e vlerësimit dhe indikatorët e parashikuar nga ligji nr. 96/2016.

Trupi gjykues pranoi kërkesën e Komisionerit Publik, duke kërkuar në vijim pranë KLGJ-së dokumentacion shtesë mbi dosjen personale të magjistratit/subjektit, mendimin e Kryetarit të Gjykatës, si dhe duke kërkuar të përcillet nga Shkolla e Magjistraturës informacion mbi periudhën e studimeve të subjektit të rivlerësimit në programin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, si dhe angazhimin e tij në formimin vazhdues pranë kësaj shkolle.

II. Lidhur me *faktin, nëse rezultati i vlerësimit të aftësisë profesionale në rastin konkret është i justifikuar, nëse do të analizohet mbi bazën e një metodologjie të specifikuar në indikatorë konkretë, për çdo çështje objekt rivlerësimi*

Për këtë shkak ankimi, në seancën e datës 26.7.2019, në vijim dhe të prezantimit me aktet e sjella nga Kryetari i Gjykatës Administrative, Shkalla e Parë, Tiranë, nga KLGJ-ja dhe Shkolla e Magjistraturës, Komisioneri Publik kërkoi prej Kolegjit të Posaçëm të Apelit kryerjen e

një vlerësimi paraprak profesional për subjektin e rivlerësimit, mbështetur në metodologjinë e propozuar nga Kolegji.

Trupi gjykues vendosi të mos pranojë kërkesën e Komisionerit Publik, si dhe vendosi mbylljen e shqyrtimit gjyqësor, duke ftuar palët të paraqesin konkluzionet përfundimtare në seancën e datës 9.9.2019, ora 10:00.

Komisioneri Publik, në funksion të kërkimit përfundimtar drejtuar juridiksionit kontrollues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, mbi çështjen që i përket ankimit të vendimit nr. 60/2018, në supozim të miratimit të draftmetodologjisë së paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësor, ka realizuar vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke reflektuar gjetjet në 13 çështjet e trajtuara bazuar në tregues të matshëm, të shënjuar +/- për çdo indikator dhe nënindikator vlerësimi, të parashikuar nga ligji nr. 96/2016. Këtyre parashtrimeve përfundimtare i bashkëlidhet dhe tabela e metodologjisë së paraqitur nga ky trup gjykues, e plotësuar për çdo rubrikë të saj për subjektin konkret.

Rezultatet e draftmetodologjisë, në vlerësimin tonë, mundësuan realizimin e një sistemi vlerësimi konkret dhe të matshëm për rastin në fjalë, duke mundësuar identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit është i kualifikuar për të kryer funksionin e tij apo ka mangësi procedurale, që mund të korrigjohen përmes edukimit, në zbatim të nenit E, të aneksit të Kushtetutës.

Rezultatet dhe panorama e krijuar nga shënjimi i treguesve të kësaj metodologjie, ku në rastin konkret gjetjet negative (-) të konstatuara, mbizotërojnë në 13 rastet e trajtuara, kryesisht në zbatimin e parimit të përgjithshëm të teorisë së të drejtës mbi përdorimin e *lex specialis*¹, parashikuar nga neni 72/2, i ligjit nr. 96/2016, aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë, *respektimi i afateve ligjore*, parashikuar nga neni 74/2, si dhe aftësinë për të administruar dosjet, parashikuar nga neni 74/5, i ligjit nr. 96/2016, janë vlerësuar në raport me rezultatet pozitive (+), të rezultuara në vlerësim të indikatorëve të tjerë, marrë dhe nga burimet shpesh të vlerësimit, të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Në mendimin e Kryetarit të Gjykatës Administrative, Shkalla e Parë, ndër të tjera, shpjegohet ngarkesa në punë e subjektit të rivlerësimit, etika dhe integriteti i tij (*neni 75/2-3, i ligjit nr. 96/2016*), paanësia në lidhje me kujdesin ndaj konfliktit të interesit dhe respektimin e çështjeve të grupeve në nevojë (*neni 75/4, i ligjit nr. 96/2016*), ndërsa në shkresën e përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës, ku shpjegohet pjesëmarrja e magjistratit në formimin vazhdues të Shkollës së Magjistraturës (*neni 76/4, i ligjit nr. 96/2016*), ndër të tjera, informohemi që subjekti i rivlerësimit, në renditjen përfundimtare të kandidatëve magjistratë, të diplomuar në vitin akademik 2004-2005, është radhitur i treti, burime këto të cilat krijuan një panoramë të plotë mbi cilësitë personale dhe angazhimin profesional të subjektit të rivlerësimit, si indikator vlerësimi i parashikuar nga neni 76, i ligjit nr. 96/2016.

Komisioneri Publik, bazuar në rezultatet e draftmetodologjisë, duke i konsideruar ato në një vlerësim tërësor të rrethanave të çështjes, në raport me sa është administruar nga aktet në dosje të Komisionit, si dhe në analizë të përmbajtjes së akteve të reja, të administruara gjatë hetimit

¹ Lex specialis derogate legi generalis.

gjyqësor, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk rezulton që me njohuritë, aftësitë në gjykim, qëndrimet e tij paraqet një model pune aq të dobët, saqë rrezikon ose cenon të drejtat e qytetarëve, dhe për rrjedhojë vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit arrin një nivel kualifikues: “I aftë”, në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas kuptimit që i jep këtij nivel, neni 44, i ligjit nr. 84/2016.

Komisioneri Publik i qëndron mendimit se vlerësimi i kriterit të aftësive profesionale, sipas një metodologjie të bazuar në një standard vlerësimi pikëzimi apo të matshëm, shërben për të krijuar një panoramë të plotë, duke pasqyruar në mënyrë konkrete, rast pas rasti, anët pozitive dhe negative që shfaq veprimtaria e subjekteve të rivlerësimit.

Ky fakt, në vlerësimin e Komisionerit Publik, u vu në dukje dhe nga Kryetari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, në mendimin e shprehur për vlerësimin profesional të subjektit, ku ndër të tjera është shprehur se: *“Ju sjell në vëmendje se deri në këtë kohë, kur kërkohet mendimi në lidhje me gjyqtarin Gentian Medja, nuk ka standarde të vendosura nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në funksion të ligjit nr. 96/2016, lidhur me standardin e vlerësimit, me këtë kuptoj më së pari sistem pikëzimi për efekt të shkallëve të vlerësimit”*.

III. Lidhur me orientimin mbi disa udhëzime të përgjithshme mbi qasjen dhe metodologjinë e vlerësimit të aftësive profesionale

Komisioneri Publik, në shkaqet e ankimit të paraqitur, ka vlerësuar të nevojshme mundësinë që, bazuar në nenin 66/2, të ligjit nr. 84/2016, Kolegji t’i rekomandojë Komisionit në formën e një orientimi mënyrën e rivlerësimit të aftësisë profesionale, duke u bazuar jo vetëm në raportet e hartuara nga organet ndihmëse të këtij procesi, por duke u bazuar dhe në një metodologji të tyre dhe më konkrete në plotësim dhe të gjithë indikatorëve dhe nënindikatorëve ligjorë, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, duke i dhënë këtij kriteri peshën e duhur në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në funksion të qëllimit kushtetues e ligjor që ka ky proces, si dhe duke evidentuar kërkesën për burime shtesë, kur të dhënat e rezultuara nuk arrijnë të krijojnë një panoramë të qartë.

VI. Kërkimi përfundimtar

Nga sa u parashtrua më sipër, në vlerësim të përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, ashtu sikurse dhe praktika ka treguar, kërkimi i ankimit të Komisionerit Publik kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit mund të jetë alternativ, kur rrethanat faktike dhe juridike e lejojnë atë.

Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, në referencë të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, u mbështeten në administrimin e provave dhe akteve të reja, të cilat, në gjykimin tonë, treguan nevojën që këto akte kanë të administrohen dhe nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë hetimit administrativ, mbi kriterin e aftësive profesionale, dhe në përfundim përmbajtja e tyre t’i nënshtrohet një sistemi vlerësimi bazuar në përdorimin e një metodologjie të re, që përfshin të gjithë indikatorët e parashikuar nga ligji nr. 96/2016.

Komisioneri Publik, në vlerësimin tërësor të të gjitha provave, të administruara gjatë shqyrtimit dhe hetimit gjyqësor të kësaj çështjeje, nisur nga faktet se:

- ankimi i paraqitur ndaj vendimit nr. 60/2018, në konsideratë dhe të rekomandimit të ONM-së, është i pari ankim që i nënshtrohet juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale;
- Kolegji i Posaçëm i Apelimit evidentoi qartësisht kompleksitetin e kësaj çështjeje, e cila, në vlerësim të Komisionerit Publik, duhet trajtuar në aspektin e përgjithshëm të përcaktimit të një metodologjie specifike gjithëpërfshirëse, që do të mundësonte një vlerësim konkret dhe të matshëm mbi aftësitë apo mangësitë profesionale të subjekteve të rivlerësimit;
- shqyrtimi gjyqësor i kësaj çështjeje tregoi nevojën për administrimin e provave dhe akteve të reja shkresore;
- bazuar në të dhënat e matshme, që Komisionerit Publik i kanë rezultuar nga vlerësimi tërësor i indikatorëve dhe nënindikatorëve të ligjit nr. 96/2016, mbi vlerësimin e burimeve të vlerësimit për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, në supozim të miratimit të draftmetodologjisë së propozuar;
- nisur nga fakti se Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin F, pika 7, e aneksit të Kushtetutës lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim me shkrim të arsyetuar, si dhe bazuar në nenin 66, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit Kolegji i Apelimit, në arsyetimin e vendimit të tij, orienton Komisionin për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme;

i kërkon këtij trupi gjykues lënien në fuqi të vendimit nr. 60, datë 1.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Gentian Medja, duke arsyetuar (Kolegji) në vendimin e tij dhe orientimin që duhet të ketë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit mbi mënyrën e rivlerësimit të aftësisë profesionale, bazuar jo vetëm në raportet e hartuara nga organet ndihmëse të këtij procesi, por duke u bazuar dhe në këtë metodologji konkrete, në plotësim dhe të gjithë indikatorëve dhe nënindikatorëve ligjorë, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, ashtu sikurse u trajtua dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të kësaj çështjeje.

KOMISIONERI PUBLIK
Florian BALLHYSA